

MENDIM PAKICE

1. Unë Etleda Çiftja, anëtare e trupit gjykues, parashtoj mendimin kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues, e cila ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit. Shumica e trupit gjykues në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton se: “[...] *Trupi gjykues, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 22.10.2019 – me të cilin KLGJ-ja ka deklaruar mospasjen e statusit magjistrat, si dhe me urdhrin nr. ***, datë 25.11.2019, dhe me të cilin ky institucion e ka liruar nga detyra e inspektore znj. Zhilla – ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Sofia Zhilla nuk e ka statusin e magjistratit dhe as nuk gjendet më në pozicionin e inspektore. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në këtë kontekst të veçantë dhe për shkak të efekteve e pasojave të shkaktuara nga aktet e sipërcituara, znj. Zhilla (ndërkohë) ka humbur edhe statusin e subjektit të rivlerësimit [...]*”.

2. Unë si anëtare në pakicë, në ndryshim nga sa arsyeton shumica e trupit gjykues, vlerësoj se znj. Sofia Zhilla nuk e ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit, për shkaqet e mëposhtme:

i) Fitimi i statusit të subjektit të rivlerësimit

3. Në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e inspektore së KLD-së. Sipas parashikimit të kësaj dispozite, i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio* të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Referuar kësaj dispozite, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se subjekt rivlerësimi janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit e ka fituar këtë status ligjor që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e, për pasojë, do të duhej t’i nënshtrohej *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces.

4. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, ka qenë e emëruar në pozicionin e inspektorit të KLD-së nga kategoria e inspektorëve jomagjistratë, sipas parashikimit të nenit 14, pika 33 e ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar dhe, **për rrjedhojë, ka statusin e subjektit të rivlerësimit.**

ii) Shkaqet e përdorura nga shumica për humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit

5. Shumica e trupit gjykues ka arsyetuar si shkaqe që çojnë në humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit: (i) *Mospasja e statusit të magjistratit*, sipas vendimit nr. ***, datë 22.10.2019, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka konkluduar mbi deklarimin e mospasjes së statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla. Ky vendim është ankimuar nga znj. Zhilla dhe Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ***, datë 18.2.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditëses Sofia Zhilla. Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë, ku kjo çështje ndodhet ende në pritje për t’u shqyrtuar, për pasojë

konsiderohet se vendimi nuk ka marrë formë të prerë; (ii) *Shkaku i dytë mbi të cilin është bazuar shumica e trupit gjykues, është fakti se subjekti i rivlerësimit nuk është më në pozicionin e inspektores*, sipas urdhrorit nr. ***, datë 25.11.2019, “Për lirim nga detyra”, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili ka disponuar: (i) lirim nga detyra për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, në detyrën e inspektores së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit; (ii) ndërprerjen e marrëdhënieve juridike të punës dhe ato financiare. Subjekti i rivlerësimit, pas ezaurimit të ankimit administrativ pranë KLGJ-së, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë me kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrorit nr. ***, datë 25.11.2019, të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.6.2020, ka pranuar kërkesën e paditëses Zhilla, duke rrëzuar kështu urdhrin për lirim nga detyra, me pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me KLGJ-në. Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (nr. ***, datë 4.6.2020) është ankimuar nga KLGJ-ja pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 6.2.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit me nr. ***, datë 4.6.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër vendimit nr. ***, datë 6.2.2024, të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, datë 29.5.2024, me numër çështjeje të regjistruar ***. Kjo çështje ndodhet në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, për pasojë konsiderohet se vendimi nuk është përfundimtar.

6. Sipas parashikimeve të nenit 42, pikat 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë kriteret mbi të cilat kryhet procesi i rivlerësimit për këtë kategori në drejtim të vlerësimit e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit që gëzon këtë cilësi pa qenë magjistrat duhet, ndër të tjera, t’i nënshtrohej edhe testimit në Shkollën e Magjistraturës, test i cili nuk rezultoi të jetë kryer nga subjekti Sofia Zhilla, për shkak se sipas vlerësimit të saj ajo gëzonte statusin e magjistratit dhe nuk ishte e nevojshme t’i nënshtrohej këtij testi për vlerësimin e aftësive profesionale.

7. Në të njëjtën logjikë kushtetuese evidentohet edhe parashikimi i nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, në të cilin përcaktohet se: “[...] *Inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të drejtat dhe detyrimet që ka kjo kategori sipas parashikimeve të këtij ligji në varësi të vullnetit të çdo individi për të vazhduar një karrierë magjistrati apo për të ruajtur një pozicion me statusin e nëpunësit civil në administratën gjyqësore*”.

8. Vendimi i KLGJ-së, që deklaron mospasjen e statusit të magjistratit prej subjektit të rivlerësimit, por edhe sido që të jetë vendimmarrja e Gjykatës së Lartë lidhur me këtë çështje, vlerësuar në raport me parashikimin e nenit 179/b të Kushtetutës, i jep Inspektorit të KLD-së, që gjendet në këtë detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, statusin e subjektit të rivlerësimit, të pakushtëzuar nga pasja ose jo e statusit të magjistratit.

9. Për sa më lart, unë si anëtare në pakicë e gjej të pabazuar në ligj qëndrimin e shumicës së trupit gjykues, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Sofia Zhilla ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit, pasi ajo nuk gëzon statusin e magjistratit dhe nuk gjendet në pozicionin e inspektores dhe, për këto arsye, procedura administrative ka mbetur pa objekt. Sipas vlerësimit

tim, znj. Sofia Zhilla e gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit në momentin e marrjes së këtij vendimi për arsyet e mëposhtme:

1. Çështja e pasjes ose jo të statusit të magjistratit është ende në proces në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka një vendim të formës së prerë që të konfirmojë se znj. Sofia Zhilla nuk gëzon statusin e magjistratit. Për pasojë, ky shkak i përdorur nga shumica e trupit gjykues për vendimmarrjen nuk qëndron.

2. Ndërkohë që edhe shkak i dytë i vendimmarrjes së trupit gjykues se “nuk gjendet më në pozicionin e inspektores”, nuk qëndron, pasi ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ me nr. ***, datë 6.2.2024, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, datë 29.5.2024, nga znj. Sofia Zhilla dhe kjo çështje varet nga vendimi që do të marrë Gjykata e Lartë për pasjen apo jo të statusit të magjistratit.

3. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit sipas vendimit të KLGJ-së, i cili deklaron mospasjen e statusit dhe nëse Gjykata e Lartë do të jepte një vendim jo në favor të subjektit, znj. Sofia Zhilla vazhdon të ruajë statusin e subjektit të rivlerësimit dhe ndaj saj duhet të kryhet procesi i rivlerësimit.

10. Në përfundim, duke qenë se znj. Sofia Zhilla: (i) është subjekt rivlerësimi sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka shprehur vullnetin e saj për t’u dorëhequr nga procesi i rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës; (iii) ka shprehur vullnetin të qëndrojë në detyrë nëpërmjet proceseve gjyqësore, të cilat janë ende në proces në Gjykatën e Lartë, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se trupi gjykues duhet të kishte vijuar me procesin e rivlerësimit ndaj saj.

Etleđa ÇIFTJA
Anëtare kundër